UDHËZIME PËR KRIJIMIN E PROFILIT DHE PËR APLIKIM NË SHPALLJEN E PUNËSIMIT

Para se të filloni me krijimin e profilit tuaj Ju këshillojmë ta përdorni shfletuesin e internetit Google Chrome sepse aplikacioni i regjistrimit funksionon më së miri në këtë shfletues.

Gjithsesi, mund të përdorni edhe shfletuesit e tjerë të internetit. Për të aplikuar në shpallje, duhet të regjistroheni në linkun që vijon: <u>www.prijava.aa.mk</u> Të nderuar,

Për të aplikuar siç duhet në shpallje është e nevojshme që ta plotësoni profilin tuaj me informacionet dhe dokumentet e duhura në pjesën **PROFILI IM** (të dhënat personale, arsimi, përvoja e punës, kompetencat e punës dhe të dhëna tjera që janë në interes të vendit të punës për të cilin aplikoni.

Gjatë plotësimit të të dhënave në profilin është e rëndësishme që **medoemos** ti bashkangjitni dokumentat përkatëse të skenura (PDF ose JPG) të cilat vërtetojnë se i plotësoni kushtet që kërkohen në shpallje.

Që të mundeni ta rregulloni profilin tuaj është e nevojshme të ndjekni udhëzimet që vijojnë:

HAPI 1 – TË DHËNAT PERSONALE

Në pjesën të dhënat për plotësimin e kushteve të përgjithshme, detyrimisht duhet të bashkangjitni dokumentat në vijim:

dëshmi për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut - (vërtetim i shtetësisë) dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (kandidati medoemos duhet të bashkëngjisë një VËRTETIM MJEKËSOR të lëshuar nga një mjek i specializuar në mjekësinë e punës, e cila vërteton se kandidati është i aftë për punë)

Nëse plotësoni ndonjë nga kushtet shtesë, këshillohet të bashkëngjitni një dokument (në pjesën e shpjeguar në Hapin 5) që konfirmon këtë.

	РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА АГЕНЦИЈА ЗА АДМИНИСТРАЦИЈА		Тест Апликација Ид. код: F051A5E	
	МОЈ ПРОФИЛ 1 ЛИЧНИ ПОДАТОЦИ ОБРАЗОВАНИЕ	(3) РАБОТНИ ИСКУСТВА	(4) РАБОТНИ КОМПЕТЕНЦИИ (5) ДРУ	
1		test.aplikacija2015(1- 1-	
	ПОДАТОЦИ ЗА ИСПОЛНУВАЊЕ НА ОПШТИТЕ УСЛОВИ Дали сте државјанин на Република Македонија? Дали имате општа здравствена способност за работа? Дали активно го користите македонскиот јазик? Да Не Да Не Да Не Да Не			
	ПОДАТОЦИ ЗА ИСПОЛНУВАЊЕ НА ДОПОЛНИТЕЛНИ УСЛОВИ Дали имате статус на корисник на државна стипендија? Да Не Да Не	бни Дали имате статус на дета до својата осумнаесетгоди Да Не	е без родители и без родителска грижа кое ишна возраст имало ваков статус?	

Nextsense® Copyright 2015. All rights reserved.



HAPI 2 - ARSIMI

Në pjesën e arsimit, klikoni butonin **Shto** dhe vendosni të gjitha informacionet e nevojshme për arsimin tuaj. Është e **detyrueshme** bashkëngjitja e diplomave të nivelit të fundit të arsimit, diplomave të mëparshme të arsimit (dëftesat e arsimit të mesëm të të gjitha viteve), diploma të magjistraturës ose doktoraturës etj., si dhe dokumenti për **nostrifikimin dhe ekuivalencë** për ata kandidatë që kanë mbaruar shkollimin jashtë vendit. **E RËNDËSISHME**:

Nëse në këtë pjesë keni të bashkangjitur diplomë të arsimit të përfunduar ku nuk është shënuar nota mesatare, duhet të bashkëngjitni dokument shtesë (Vërtetim) që përmban notën mesatare. Kjo vlen për dokumentet e kërkuara për arsimin e lartë dhe dokumentet e kërkuara për arsimin e mesëm.

Për ata kandidatë të cilët kanë mbaruar shkollimin në Universitet në Republikën e Maqedonisë ku nota mesatare nuk është me numër, është e nevojshme të bashkëngjitet dokument për ekuivalencë i lëshuar nga fakulteti përkatës, i cili do të vërteton notën mesatare të pranuar në Republikën e Maqedonisë.



~

Промени лозинка

😔 Одјави се

КОМПЛЕТНОСТ НА профилот



УПАТСТВА

> Упатство 1...

> Упатство 1...

> Упатство 1...

HAPI 3 – PËRVOJË PUNE

Në pjesën përvojë pune, nëse keni përvojë pune, klikoni në butonin Shto dhe vendosni të dhënat e nevojshme që kërkohen. Gjithashtu duhet të bashkëngjitni Histori për punësim të lëshuar nga Agjencia e punësimit (kjo nuk vlen për personat pa përvojë pune).

Gjithashtu, Historisë për Punësim, kandidatët mund t'i bashkëngjisin Vërtetim të përvojës së punës, Vendim pune, Kontratë pune dhe etj. ku do të shpjegojë më hollësisht pozicionin e punës ku ka qenë i përcaktuar në vendet e mëparshme të punës.



поминал во работен однос после стекнување на определен степен и вид на образование и во кој вршел работи и

Моментално немаме информации за вашето работно искуство. Со додавање на соодветно работно искуство ја зголемувате вашата

работни задачи за кој е потребен таков степен и вид на образование.

 \sim

шанса за вработување.



HAPI 4 – KOMPETENCAT E PUNES

Në këtë pjesë duhet të futni të dhënat e nevojshme për sa i përket njohurive, shkathtësive dhe aftësive që zotëroni, lidhur me programet kompjuterike për punë zyre.

Kompetencat e punës lidhur me njohuritë e programeve kompjuterike, kandidatët do ti dëshmojnë duke i bashkangjitur detyrimisht certifikatat e nevojshme për punën me programe kompjuterike për punë zyre.

	РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА АГЕНЦИЈА ЗА АДМИНИСТРАЦИЈА Ид. код: F051A5E
	МОЈ ПРОФИЛ 1 ЛИЧНИ ПОДАТОЦИ 2 ОБРАЗОВАНИЕ 3 РАБОТНИ ИСКУСТВА 4 РАБОТНИ КОМПЕТЕНЦИИ 5 ДРУГИ
Ŧ	Работни компетенции се збир од знаења, вештини и способност на вработениот за да ги извршува работите и работните задачи на работното место.
	компјутерски вештини
1	

Внесете слободен текст каде ќе ги опишете вашите познавање во областа на компјутерите. После зачувување прикачете и сертификати доколку имате.

ПОЗНАВАЊЕ НА СТРАНСКИ ЈАЗИЦИ

~

Моментално немаме информации дека познавате некој странски јазик. Со додавање на странски јазици ја зголемувате вашата шанса за вработување.

Nextsense@ Copyright 2015. All rights reserved.

+ Додади



HAPI 5 - TË DHËNA TË TJERA

Në këtë pjesë bashkëngjitni të gjitha format e tjera të arsimit profesional, diploma apo çertifikata, rekomandime pozitive nga vendi punës së mëparshëm për të cilin është regjistruar përvoja e punës të paktën 1 vit, vërtetim për përvojë vullnetare në institucionet e sektorit publik të paktën 6 muaj, deklaratë ose dokumenta tjera që posedoni dhe që janë në interes për vendin e punës.

Gjithashtu, kandidatët në këtë pjesë mund të bashkëngjisin vërtetimin për provim të dhënë profesional ose licencë ose vërtetim nga fusha përkatëse profesionale, nëse janë kusht i veçantë për vendin e punës dhe emërohen në shpallje publike.

Pas krijimit të profilit me sukses, kandidati merr kod identifikues që duhet ta ruajë deri në përfundim të shpalljes për të cilin ka aplikuar, sepse do ta përdorë atë në të gjitha fazat e procedurës së përzgjedhjes.

Në të njëjtën kohë, kandidati të njëjtin kod identifikues do ta përdorë edhe në shpalljet tjera ku do të aplikojë.



HAPI 6 -

Pasi të keni plotësuar profilin tuaj me informacionet dhe dokumentet e nevojshme, klikoni në Shpallje aktive, zgjidhni një nga shpalljet aktive, zgjidhni një vend punë ku kualifikoheni dhe shtypni butonin APLIKO.

E RÊNDÊSISHME: Në rast se keni aplikuar me dokumentet e nevojshme në shpallje, pastaj keni shtuar dokumenta të reja në profilin tuaj, pra keni bërë ndryshim në të dhe dëshironi t'i përdorni të njëjtat në shpalljen ku keni aplikuar në afatin e paragitjes, duhet të shtypni butonin "Anulo aplikimin" dhe përsëri të aplikoni në të njëjtin vend pune, pra të njëjtën shpallje me profil të ndryshuar dhe të plotësuar, që të mirren parasysh të gjitha dokumentat që i keni bashkangjitur.

Me fat!